

Msc. Admira Tatzati
Dr. Etleva Nita (Breshani)

LIBËR MËSUESI

GJEOGRAFIA

Për klasën e 6-të të arsimit të mesëm të ulët



BOTIMET "DITA PRINT"



LIBRI I MËSUESIT
GJEOGRAFIA

6

Tiranë 2015

Autorët: Msc. Admira Tatzati
Dr. Etleva Nita (Breshani)

Redaktore letrare: Alketa Leka (Liçi)
Korrektore letrare: Siderita Musabelliu (Çela)
Arti grafik: Liliana Alibali

© Dita Print

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara

Shtypur në shtypshkronjën “Dita Print”

Adresa: Bulevardi “Gjergj Fishta” (pranë Fakultetit të Shkencave Sociale)

Fax/Tel.: +355 4 22 73 745 ;Cel.: +355 068 20 42 171; 068 20 55 009

E-mail: ditaprint@hotmail.com

Tiranë, 2015

HYRJE

Teksti shkollor **Gjeografia 6** është një qasje dinamike e dijeve shkencore të gjeografisë, në përputhje me programin e ri të Ministrisë së Arsimit të vitit 2015-2016. Teksti shkollor Gjeografia 6 do të njohë nxënësin me qëllimin, synimet, mjetet dhe metodat e shkencës së Gjeografisë. Të mësuarit e gjeografisë i ofron nxënësit mundësinë të kuptojë veçoritë natyrore dhe shoqërore të mjedisit gjeografik, diversitetit (shumëllojshmëritë) të vendeve e rajoneve të ndryshme, ndërvarësisë dhe marrëdhënieve të njeriut me mjedisin. Informacioni i shumëllojshëm dhe globalizimi i ekonomisë dhe kulturës të cilat kanë ndikuar në komunikimin e shpejtë të shoqërisë njerëzore do të shihen në perspektivën e lëndës së gjeografisë.

Teksti shkollor Gjeografia 6, mundëson që përveç të mësuarit të gjeografisë përmes tregimit të përdori dhe burime shkencore dhe pamje në ndryshme nga peizazhi natyror dhe njerëzor në mënyrë që të nxisë të menduarin kritik tek nxënësit e moshës 13-vjeçare. Duke nxitur mendimin kritik e përgatit nxënësin për t'u përshtatur dhe vepruar me maturi në procesin e shpejtë të ndryshimit të shoqërisë. Ky tekst ka rëndësi sepse kultivon identitetin personal, shoqëror e kombëtar duke arritur synimin e përgatitjes së qytetarit evropian me individualitet kombëtar.

Gjeografia 6 mbështetet në tre faza të rëndësishme

- Faza e parë **zbulimi** i informacionit nëpërmjet tekstit tregues
- Faza e dytë **vëzhgimi** i burimeve pamore si: fotografi, grafike, harta, diagrame etj.
- Faza e tretë **sintetizimi** i njohurive të marra duke kryer veprimtari të ndryshme në Rubrikën *“luaj si gjeograf”*

Në përfundim të tre fazave nxënësi, me ndihmën e mësuesit që e ka udhëhequr në secilën veprimtari do të arrijë të fitojë kompetenca për kërkimin e pavarur të informacionit, gjetjen e zgjidhjeve të ndryshme për të njëjtin problem, gjykime dhe arsyetime të pavarura.

Gjeografia 6 krijon kushte dhe formëson kompetenca që nxënësi të ndërtojë dhe zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike. Janë pikërisht këto elementë që duhet të realizojë shkolla dhe ta bëjnë nxënësin të aftë që të përballojë problemet të tilla si: mbipopullimi, ndotja apo krizat ekonomike që përfshijnë botën.

Autorët: Admira Tatzati
Etleva Nita

KURRIKULA ME BAZË KOMPETENCAT

Arsimi i ka shërbyer njeriut dhe interesave të tij, por kjo nuk ka ndodhur gjithmonë sepse në raste të veçanta edhe i është kundërvënë atij. Për këtë arsye arsimi ka qenë gjithnjë objekt kritikash, rishikimesh dhe reformimesh. Edhe sot koha kërkon një arsim të konsoliduar, një arsim që ka si pikënisje dhe pikëmbërritje kompetencat për të gjithë jetën dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës. Arsimi të jetë i orientuar nga e ardhmja dhe t'i vlejë edhe të ardhmes, dhe ky është pikërisht thelbi i reformës. Parimet dhe veçoritë e të nxënit dhe mësimdhënies në reformën e re bazohet në kompetenca dhe **përmbajtja lëndore konceptohet si mjet për realizimin e tyre nëpërmjet zhvillimit të situatave të të nxënit.**

Kompetencat kyçe

Kompetencat kyçe për nxënien gjatë gjithë jetës janë në përputhje me qëllimet e arsimit parauniversitar.

Ato reflektohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit, të cilat shprehin atë se çfarë duhet të arrijnë nxënësit në mënyrë progresive dhe të vazhdueshme deri në fund të arsimit bazë.

Kompetencat përfshijnë një sistem të integruar dhe koherent të dijeve, të shkathtësive dhe të qëndrimeve të aplikueshme dhe të transferueshme, të cilat do të ndihmojnë nxënësit të ballafaqohen me sfidat e epokës digjitale, të ekonomisë së tregut të lirë në një botë globale të marrëdhënieve të ndërvarura.

Kompetencat kyçe janë:

- Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit.
- Kompetenca e të menduarit.
- Kompetenca e të mësuarit për të nxënë.
- Kompetenca për jetë, sipërmarrje dhe mjedis.
- Kompetenca qytetare.
- Kompetenca digjitale.
- Kompetenca personale.

Kompetencat kyçe realizohen nëpërmjet rezultateve të të nxënit. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së gjeografisë janë:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim,

si dhe në forma të tjera të komunikimit.

- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media.
- Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë.
- Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.
- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

Kompetenca e të nxënësve (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose sipas rëndësisë që kanë për temën internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, media) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.

- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.
- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

Kompetenca personale (*Nxënësi bën jetë të shëndetshme*)

- Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

- Përdor media digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë *për zhvillimin e njohurive*.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

Mësuesi përzgjedh vetë ato kompetenca që mendon se do të realizojë për një tematikë të caktuar.

E gjithë kurrikula e re e organizon arsimin parauniversitar në shkallë dhe koncepti i shkallëve të kurrikulës bazohet në veçori të përbashkëta që kanë të bëjnë me karakteristikat e zhvillimit moshor të nxënësve.

Shkallët mundësojnë:

- respektimin e karakteristikave të periudhave të ndryshme të zhvillimit të fëmijëve për caktimin e kompetencave që ato duhet të zotërojnë;
- respektimin e ritmeve individuale të nxënësve, drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës;
- fleksibilitet më të madh në planifikimin dhe organizimin e punës mësimore–edukative.

Shkallët sipas kurrikulës së re janë:

| Nivelet e sistemit të arsimit formal | Shkallët e kurrikulës |
|--|---|
| Arsimi i mesëm i lartë <i>Klasa XII</i> | <i>Shkalla e gjashtë</i> Konsolidimi i arritjeve dhe specializim |
| Arsimi i mesëm i lartë <i>Klasa X – XI</i> | <i>Shkalla e pestë</i> Zhvillimi themelor i përgjithshëm dhe profesional |
| Arsimi i mesëm i ulët <i>Klasat VIII – IX</i> | <i>Shkalla e katërt</i> Përforcim i arritjeve dhe orientim në karrierë |
| Arsimi i mesëm i ulët <i>Klasat VI – VII</i> | <i>Shkalla e tretë</i> Zhvillim i mëtejshëm i bazave dhe orientim |
| Arsimi fillor <i>Klasat III – V</i> | <i>Shkalla e dytë</i> Përforcim i bazave dhe zhvillim |
| Arsimi fillor <i>Klasat I – II</i> | <i>Shkalla e parë</i> Përvetësim i bazave për njohje |
| Klasa përgatitore | <i>Shkalla përgatitore</i> Edukim në fëmijërinë e hershme |
| Mosha 3 – 6 vjeç | |

Siç edhe e shohim klasa e 6 dhe 7 bën pjesë në shkallën e tretë.

Kurrikula e arsimit tonë parauniversitar është e organizuar në fushat e të nxënësve të cilat mundësojnë organizimin e lëndëve që kanë synime dhe detyra të përbashkëta për zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe integrimin. Fushat e të nxënësve përbëjnë bazën e organizimit të procesit mësimor-edukativ në shkollë për çdo nivel arsimor dhe shkallët përkatëse të kurrikulës. Kemi shtatë fusha të nxënësve të cilat përfshijnë një ose më shumë lëndë dhe disa lëndë të fushës mund të jenë pjesë e disa shkallëve kurrikulare.

Fushat e të nxënit janë:

1. Gjuhët dhe komunikimi
2. Matematika
3. Shkencat e natyrës
4. Shoqëria dhe mjedisi
5. Artet
6. Edukimi fizik sporte dhe shëndeti
7. Teknologji dhe TIK

Lënda e gjeografisë bën pjesë në fushën SHOQËRIA DHE MJEDISI së bashku me lëndën e historisë dhe të qytetarisë. Gjeografia është e lidhur me tema të mëdha ndërkurrikulare, tema madhore të cilat vendosen përballë shoqërisë dhe i shërbejnë zhvillimit të kompetencave.

Për të lidhur atë që nxënësi ka mësuar në shkollë me jetën e përditshme shërbejnë pikërisht këto tema madhore të cilat janë:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Përveçse me temat madhore lënda e gjeografisë është e lidhur edhe me lëndë të tjera brenda fushës si me historinë dhe qytetarinë, por edhe me lëndë të fushave të tjera si me gjuhën dhe komunikimin, matematikën, artet, shkencat e natyrës, teknologjinë dhe TIK-un dhe nëpërmjet këtyre lidhjeve ajo siguron zhvillim të kompetencave..

Kompetencat zhvillohen përmes *tematikave të përbashkëta të fushës* dhe në program zërthehen në njohuri/koncepte, aftësi/shkathhtësi, qëndrime/vlera.

Përmes tematikave të përbashkëta të fushës strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave.

Në shkallën e 3-të (klasa 6 – 7) zhvillohen tematikat:

- **Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve e mjediseve** (Klasa 6 – 35 orë, klasa 7 – 8 orë).
- **Proceset natyrore dhe shoqërore** (klasa 7 – 62 orë).

Rezultatet e të nxënit sipas tematikave

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh.

Tematikat dhe renditja e tyre nuk presupozojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje.

Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathhtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj apo grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit ku më kryesorët janë mësuesit dhe autorët e teksteve.

Tematika: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve.

Përshkrimi i tematikës:

Përmes kësaj tematike nxënësit zhvillojnë këndvështrimin e tyre hapësinor për botën, kuptojnë vendndodhjen e njerëzve, të vendeve, rajoneve dhe burimeve si dhe përshkruajnë arsyet e kësaj vendndodhjeje. Nxënësit eksplorojnë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike, faktorët fizikë dhe humanë në zhvillimin vendor, rajonal, kombëtar dhe global. Ata vëzhgojnë dhe debatojnë rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe propozojnë, krahasojnë dhe vlerësojnë alternativat e përdorimit të burimeve natyrore në komunitete, rajone, kombe dhe në botë.

Kjo tematikë e madhe ka në përbërje të saj tre nëntematika të cilat janë:

- Gjeografia dhe kërkimi gjeografik
- Hartat gjeografike
- Mjedisi ynë lokal

PLANI MËSIMOR VJETOR KLASA VI FUSHA : SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA: GJEOGRAFI

| | |
|--|--|
| TEMATIKA | NDËRVARËSIA MIDIS NJERËZVE, VENDEVE, RAJONEVE E MJEDISEVE |
| NËNTEMATIKAT | SHPERNDARJA E PËRMBAJTJES SË LËNDËS |
| GJEOGRAFIA DHE KËRKIMI GJEOGRAFIK | SHTATOR – DHJETOR / 8 orë |
| 8 ORË | 1- Çfarë studion gjeografia? 2- Pesë temat e gjeografisë. 3- Mjetet e dhe metodat e studimit të gjeografisë. 4- Gjeografia fizike dhe njerëzore. 5- Peizazhi natyror dhe njerëzor. 6- Marrëdhëniet e njeriut me mjedisin. 7- Përsëritje: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik. 8- Testim: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik. |

| | |
|--|---|
| HARTAT GJEOGRAFIKE 12 ORË | <p style="text-align: center;">JANAR - MARS / 12 orë</p> 1- Orientimi në natyrë 2- Veprimtari praktike: Përcaktimi i anëve të horizontit 3- Vendndodhja gjeografike 4- Gjatësia dhe gjerësia gjeografike 5- Koordinatat gjeografike 6- Veprimtari praktike: Përcaktimi i vendndodhjeve absolute në hartë. 7- Plani 8- Hartat gjeografike dhe llojet e tyre 9- Globi 10- Veprimtari praktike: Si të lexohet dhe të përdoret harta 11- Përsëritje: Hartat gjeografike 12- Testim: Hartat gjeografike |
| MJEDISI YNË LOKAL 15 ORË | <p style="text-align: center;">PRILL - QERSHOR / 15 orë</p> 1- Përbërja e trevave shqiptare 2- Natyra 3- Popullimi 4- Lëvizjet e popullsisë 5- Trashëgimia natyrore dhe njerëzore 6- Trashëgimia natyrore dhe kulturore Botërore dhe Kombëtare 7- Aktiviteti Prodhues 8- Qeverisja qendrore dhe vendore 9- Mjedisi dhe njeriu 10- Përsëritje “Mjedisi ynë” 11- Testim “Mjedisi ynë” 12- Punë me projekt 13- Punë me projekt 14- Punë me projekt 15- Punë me projekt |

PLANIFIKIMI 3-MUJOR

FUSHA – SHOQËRIA DHE MJEDISI

LËNDA – GJEOGRAFI

SHKALLA 3

Tematika: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve e mjediseve

Nëntematika: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik.

Kompetencat që do të realizohen gjatë procesit mësimor:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

- Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.

Kompetenca e të nxënësit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Njohuritë:

- Gjeografia dhe konceptet bazë të kërkimit gjeografik: lokalizimi/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi dhe zhvillimi.
- Kërkimi gjeografik: metodat dhe mjetet gjeografike.
- Gjeografi dhe roli i tij në studimin e dukurive gjeografike.

Shkathtësitë:

Nxënësi:

- Demonstron nëpërmjet shembujve kuptim të koncepteve që përdoren nga gjeografët për organizimin e kërkimeve të tyre si lokalizimi/vendi, mjedisi, rajoni, ndërveprimi, zhvillimi.
- Përshkruan metodat shkencore të kërkimit gjeografik, përdorimi i burimeve parësore dhe dytësore, analiza dhe interpretimi i të dhënave.
- Diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe human

Qëndrimet/vlerat:

Nxënësi:

- Demonstron interes për gjeografinë, degët e saj dhe karrierat që lidhen me të.
- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.
- e gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë.
- Diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik.

| Nr. | Nën - tematika | Tema mësimore | Situatë e parashikuar për të nxënit | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |
|-----|-------------------------------|--|---|--|------------------------|----------------------|
| 1 | Gjeografia dhe kërkimi | 1- Çfarë studion gjeografia | Një glob | Brainstorming, INSERT, pesëvargëshi | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti |
| 2 | gjeografik 8 | 2- Pesë temat e gjeografisë | Diskutim rreth një fotoje të një njeriu në mjedis | Brainstorming, Metoda e kombinimit, Turi i galerisë. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti |
| 3 | 8 orë | 3- Mjetet e gjeografisë | | | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti |
| 4 | | 4- Gjeografia fizike dhe njerëzore | | | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, foto |
| 5 | | 5- Peizazhi natyror dhe njerëzor | Foto të një peizazhi natyror dhe njerëzor | Brainstorming, INSERT, Diagrami i Venit. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, foto |
| 6 | | 6- Marrëdhëniet e njeriut me mjedisin | Foto e një ndërtese buzë liqenit të Ohrit | Brainstorming, Teknika e të pyeturit, Ditari dy pjesësh. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, interneti |
| 7 | | 7- Përsëritje: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik | | Diskutim. | Vlerësimi përmbledhës | Teksti, harta |
| 8 | | 8- Testim: Gjeografia dhe kërkimi gjeografik | | | Vlerësimi përmbledhës | Teksti, veprimtaritë |

Shënim: Në këtë tabelë janë shënuar metoda të mësimdhënies dhe situata të të nxënit që janë përdorur në temat e zhvilluara në këtë libër mësuesi, por çdo mësues është i lirë të përdorë metodat që ai dëshiron dhe mendon se janë efektive.

PLANIFIKIMI 3-MUJOR FUSHA – SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA – GJEOGRAFI

SHKALLA 3

Tematika: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve e mjediseve

Nëntematika: Hartat gjeografike.

Kompetencat që do të realizohen gjatë procesit mësimor:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

- Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore.

Kompetenca e të nxënësit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Njohuritë:

- Paraqitja grafike e Tokës: Harta, plani, globi.
- Hartat gjeografike dhe përdorimi i tyre.
- Vendndodhja gjeografike: absolute dhe relative.
- Harta e Shqipërisë; Shqipëria në Ballkan dhe Evropë.

Shkathtësitë:

Nxënësi: Krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.

- Dallon lloje të ndryshme të hartave gjeografike dhe përdorimet e tyre.
- Përdor TIK-un:
 - për të gjetur harta elektronike të llojeve të ndryshme;
 - për të përcaktuar vendndodhjen dhe largësinë midis dy vendeve.
- Shpjegon legjendën e një harte gjeografike.
- Mat distanca në vijë ajrore dhe distanca rrugore në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme.
- Përcakton vendndodhjen absolute të një vendi në hartë përmes koordinatave gjeografike.
- Dallon paraqitjen e Shqipërisë në harta të llojeve të ndryshme vendndodhjen gjeografike (absolute dhe relative) të Shqipërisë në hartën e Ballkanit, Evropës dhe botës.
- Përshekruan një itinerar në hartë kur janë dhënë drejtimet kryesore të lëvizjes dhe objekte gjeografike të dallueshme

Qëndrimet/ vlerat:**Nxënësi:**

- Demonstron kuriozitet në eksplorimin e hartave të tematikave të ndryshme.
- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përfutuara nga vëzhgimet individuale.

- Respekton idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.
- Prezanton me objektivitet rezultatet e ndryshme.
- Demonstron interes për Shqipërinë dhe pozicionin e saj gjeografik.

| Nr. | Nën - tematika | Tema mësimore | Situatë e parashikuar për të nxënësit | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |
|-----|---------------------------|---|---|---|--|-----------------------|
| 1 | Hartat gjeografike | 1- Orientimi në natyrë | Pyetja: Ku ndodhet shtëpia juaj? | Parashikimi me terma paraprakë, Teknika e të pyeturit, Shkrimi i lirë. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti |
| 2 | | 2- Veprimtari praktike: Përcaktimi i anëve të horizontit | Pyetja: Ku ndodhet shtëpia juaj duke marrë si pikë referimi shkollën? | Punë në grupe. | Vlerësim i vazhdueshëm, në grup dhe individual | Teksti |
| 3 | | 3- Vendndodhja gjeografike | Ku ndodhet avioni i rrëzuar që ka nevojë të menjëhershme për tu ndihmuar? | Parashikimi me terma paraprakë, Metoda e kombinimit, Turi i galerisë. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, harta e botës |
| 4 | | 4- Gjatësia dhe gjerësia gjeografike | | | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, harta e botës |
| 5 | | 5- Koordinatat gjeografike | Ku ndodhet avioni i rrëzuar që ka nevojë të menjëhershme për tu ndihmuar | Parashikimi me terma paraprakë, Teknika e të pyeturit, Mendo/ Puno në dyshe/ Shkëmbe. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, harta e botës |
| 6 | | 6- Veprimtari praktike: Përcaktimi i vendndodhjeve absolute në hartë. | | | Vlerësim i vazhdueshëm në grup dhe individual | Teksti, harta e botës |

| | | | | | | |
|----|--|--|---|--|------------------------|--------------------------------------|
| 7 | | 7- Plani | | | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, foto |
| 8 | | 8- Hartat gjeografike, klasifikimi dhe llojet e tyre | Harta e Botës dhe e Shqipërisë. | Brainstorming, Di/ Dua të di/ Mësoj | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, harta të llojeve të ndryshme |
| 9 | | 9- Globi | Vihet për tu dëgjuar kënga “Dhuratë për ditëlindje” | Brainstorming, INSERT, Diagrami i venit. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, globe të llojeve të ndryshme |
| 10 | | 10- Veprimtari praktike: Si të lexohet dhe të përdoret harta | | | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti, hartë e qytetit |
| 11 | | 11- Përsëritje: Hartat gjeografike | | Diskutim. | Vlerësim i vazhdueshëm | Teksti |
| 12 | | 12- Testim: Hartat gjeografike | | | Vlerësim përmbledhës | Teksti |

Shënim: Në këtë tabelë janë shënuar metoda të mësimdhënies dhe situata të të nxëniet që janë përdorur në temat e zhvilluara në këtë libër mësuesi, por çdo mësues është i lirë të përdorë metodat që ai dëshiron dhe mendon se janë efektive.

PLANIFIKIMI 3-MUJOR FUSHA – SHOQËRIA DHE MJEDISI LËNDA –GJEOGRAFI

SHKALLA 3

Tematika: Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve e mjediseve

Nëntematika: Mjedisi ynë lokal.

Kompetencat që do të realizohen gjatë procesit mësimor:

Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime

Kompetenca e të menduarit (*Nxënësi mendon në mënyrë krijuese*)

- Interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore, duke i sqaruar

Kompetenca e të nxënësit (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkenca shoqërore nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.

Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.

Kompetenca qytetare (*Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët*)

- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj., në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

Kompetenca digjitale (*Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin*)

- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës:

Njohuritë:

- Mjedisi natyror i zonës (qytetit/fshatit) së banimit.
- Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në ndryshimin e mjedisit natyror të zonës.
- Popullsia dhe lëvizjet e saj.
- Vendbanimet dhe mënyra e jetesës së njerëzve në mjedisin lokal.
- Trashëgimia natyrore dhe kulturore e mjedisit lokal.
- Aktivitetet prodhuese dhe organet e qeverisjes lokale e qendrore të mjedisit që na rrethon.
- Zhvillimi mjedisor dhe bashkëveprimi komunitar për mbrojtjen e tij.

Shkathtësitë:

Nxënësi:

- Interpreton në hartë vendndodhjen e zonës (qytetit/fshatit) ku banon.
- Përshkruan përbërësit kryesorë të relievit duke dalluar elementë të veçantë, burimet ujore (burime, lumenj, liqene, dete etj.), botën bimore dhe shtazore, mikroklimën në mjedisin ku jeton.
- Vëzhgon dhe sjell shembuj si kanë ndikuar këto burime në jetën e banorëve.
- Diskuton mbi rrugët nëpërmjet të cilave njerëzit kanë shfrytëzuar pasuritë natyrore (p.sh., përdorimi i gurëve, rërës, ndërtimi hidrocentraleve etj.).
- Përshkruan strukturën moshore të popullsisë në zonën ku jeton;

- Mbledh të dhëna statistikore për të shpjeguar lëvizjet e popullsisë së zonës në periudha të ndryshme dhe shkaqet.
- Dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/fshatin e tij.
- Krahason mënyrën e jetesës së popullsisë në mjedisin e tij lokal me atë të popullsisë në mjedise të tjerë.
- Evidenton monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës, vlerat turistike që kanë monumentet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës, rreziqet natyrore dhe antropogjenë që kërcënojnë vlerat e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të zonës.
- Identifikon llojet kryesore të veprimtarive prodhuese ekonomike, industriale dhe tregtare në mjedisin lokal.
- Përcakton vendndodhjen e rrugëve lokale e kombëtare, të ndërtesave të qeverisjes lokale e qendrore, objektet e edukimit të nxënësve, parqe, biblioteka etj.
- Parashtron ide (me shkrim dhe me gojë) mbi ndikimin e veprimtarisë së njeriut në mjedisin natyror të zonës dhe nevojën e bashkëpunimit komunitet–qeverisje lokale për mbrojtjen e mjedisit.
- Përdor hartën topografike të qytetit/fshatit për t’u orientuar në mjedisin e tij lokal.

Qëndrimet/ vlerat:

Nxënësi:

- Pranon dhe respekton diversitetin natyror, shoqëror, kulturor të zonës ku banon.
- Demonstron përkujdesje dhe ndjeshmëri për burimet natyrore dhe ruajtjen e tyre.
- Vlerëson me objektivitet rezultatet e të dhënave krahasuar me ato të shokëve.
- Respekton idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët.

| Nr. | Nën - tematika | Tema mësimore | Situatë e parashikuar për të nxënësit | Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | Vlerësimi | Burimet |
|-----|-------------------|---------------------------------|---|--|----------------------|------------------------------------|
| 1 | Mjedisi ynë lokal | 1- Përbërja e trevave shqiptare | Pyetja: Pse themi shqiptarët e Strugës, Ohrit, Preshevës, Ulqinit, Janinës? | Brainstorming, INSERT, Kllaster | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare. |

| | | | | | | |
|----|--|--|--|---|--|--|
| 2 | | 2- Natyra | | | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 3 | | 3- Popullimi | | | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 4 | | 4- Lëvizjet e popullsisë | Largimi i disa nxënësve në Gjermani | Brainstorming, Teknika e të pyeturit, Shkrim i Lirë. | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 5 | | 5- Trashëgimia natyrore dhe kulturore | | | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 6 | | 6- Trashëgimia natyrore dhe kulturore Botërore dhe Kombëtare | UNESCO dhe trevat shqiptare | Brainstorming, Metoda e Kombinimit, Tabela përmbledhëse e koncepteve. | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 7 | | 7- Aktiviteti Prodhues | Pyetja: çfarë keni konsumuar sot për mëngjes? Ku janë prodhuar? | Parashikimi me terma paraprakë, INSERT, Kllaster. | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 8 | | 8- Qeverisja qendrore dhe vendore | | | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 9 | | 9- Mjedisi dhe njeriu | Kronika në TV për ndërtimin e landfillit të plehrave në një ndër qytetet më të ndotura në Shqipëri në Elbasan. | Brainstorming, INSERT, Shkrim i lirë. | Vlerësimi i vazhduar | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 10 | | 10- Përsëritje “Mjedisi ynë” | | Diskutim. | Vlerësim përmbledhës | Teksti, harta e trevave shqiptare |
| 11 | | 11- Testim “Mjedisi ynë” | | | Vlerësim përmbledhës | Teksti |
| 12 | | 12- Punë me projekt “Mjedisi ynë” | | | Vlerësim i punës në grupe dhe individual | Teksti, të dhëna nga bashkia, shkrime nga shtypi, foto personale, enciklopedi, internet etj. |

| | | | | | | |
|----|--|-----------------------------------|--|--|--|--|
| 13 | | 13- Punë me projekt “Mjedisi ynë” | | | Vlerësim i punës në grupe dhe individual | Teksti, të dhëna nga bashkia, shkrime nga shtypi, foto personale, enciklopedi, internet etj. |
| 14 | | 14- Punë me projekt “Mjedisi ynë” | | | Vlerësim i punës në grupe dhe individual | Teksti, të dhëna nga bashkia, shkrime nga shtypi, foto personale, enciklopedi, internet etj. |
| 15 | | 15- Punë me projekt “Mjedisi ynë” | | | Vlerësim i punës në grupe dhe individual | Teksti, të dhëna nga bashkia, shkrime nga shtypi, foto personale, enciklopedi, internet etj. |

Planifikimi orës mësimore Nr. 1


| | | | |
|--|-------------------------|---|------------------|
| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
| Tema mësimore: ➤ Çfarë studion gjeografia? | | Situata e të nxënësve: ➤ Shohim një glob dhe kuptojmë se ai është toka e zvogëluar. ➤ Çfarë do të studiojmë në të? | |
| Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës/ lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton kuptimin e termit gjeografi ➤ Evidenton objektin e studimit të gjeografisë ➤ Analizon duke dhënë shembuj rëndësishëm të studimit të gjeografisë | | Fjalët kyçe: gjeografi, dukuri gjeografike | |
| Burimet: Teksti, interneti | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, biologji | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Struktura e mësimit | | | |
| E | Brainstorming | 5 min | |
| R | Insert | 25 – 30 min | |
| R | Pesëvargëshi | 10 min | |

Zhvillimi i mësimi
Evokimi (Brainstorming)

Shkruhet në tabelë tema e mësimi dhe iu kërkohet nxënësve të japin idetë e tyre për temën se çfarë studion gjeografia. Mendimet e tyre mësuesi i shkruan në tabelë (tek skema).

Çfarë studion gjeografia?

(shkruhet brenda rrethit)



Realizimi i të kuptuarit (INSERT)

Mësuesi/ja i vendos nxënësit të lexojnë mësimin në tekst duke pasur parasysh të vendosin shenjat përkatëse të tabelës insert për informacionin. Informacioni i shenjësuar hidhet pastaj në tabelën INSERT sipas shenjave përkatëse.

| “ √ ” | “ + ” | “ - ” | “ ? ” |
|-------|-------|-------|-------|
| | | | |

Reflektimi (Pesëvargëshi)

Krijoni një pesëvargësh për temën “Çfarë studion gjeografia”


Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Ese: Pse ju pëlqen të mësoni lëndën e gjeografisë?

Planifikimi i orës mësimore Nr. 2

| | | | |
|---|----------------------------|---|------------------|
| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
| Tema mësimore: ➤ Pesë temat e gjeografisë. | | Situata e të nxënit: ➤ Ebola dhe përhapja e saj. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton pesë temat e gjeografisë ➤ Shpjegon konceptet vend, lëvizje, rajon, lidhje e njeriut me mjedisin ➤ Analizon rëndësinë e njohjes së pesë temave të gjeografisë | | Fjalët kyçe: Pesë temat e gjeografisë, vendi, rajoni, lëvizja, lidhja e njeriut me mjedisin | |
| Burimet: Teksti, harta e botës, fletët e ekspertit | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, biologji, qytetari | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e mësimit | | | |
| E | Brainstorming | 5 min | |
| R | Metoda e kombinimit | 25 – 30 min | |
| R | Turi i galerisë | 10 min | |
| Zhvillimi i mësimit | | | |
| Evokimi (Brainstorming) | | | |
| Mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimit dhe u kërkon nxënësve të japin mendimet e tyre rreth temës. Mësuesi i shkruan ato në tabele sipas skemës. | | | |
| Cilat janë pesë temat e gjeografisë? <i>(Fjalët futen brenda rrethit)</i> | | | |
|  | | | |

Realizimi i të kuptuarit (Metoda e kombinimit)

Formohen grupet fillestare të bashkëpunimit dhe nxënësit pajisen me tekstin përmbledhës të temës dhe me fletët e ekspertit, sipas zgjedhjes.

Më pas nxënësit rigrupohen sipas numrave përkatës dhe krijohen grupet e ekspertëve.

Në fund kthehen nxënësit në grupet fillestare të bashkëpunimit, tashmë të përgatitur si ekspertë për t'ua shpjeguar të tjerëve.

Grupi i I – Vendi

Grupi i III – Lidhja e njeriut me mjedisin

Grupi i II – Lëvizja

Grupi i IV – Rajoni

(Mësuesi fotokopjon materialet përkatëse duke i quajtur fleta ekspertit 1, 2, 3, 4)

Të gjitha të dhënat bashkë me shembujt që grupet kanë sjellë përmbledhen dhe shënohen në letër flipçart duke u afishuar në një vend të dukshëm.

Reflektimi (Turi i galerisë)

Të gjithë nxënësit lexojnë materialet e afishuara dhe ata mund të diskutojnë apo shtojnë mendime të tjera në to.

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tyre.

Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Krahasoni mjedisin tuaj me një mjedis tjetër që juve ju pëlqen duke pasur parasysh karakteristika të ndryshme.

Planifikimi i orës mësimore Nr. 3

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedis Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|---|--|------------------|
| Tema mësimore: ➤ Marrëdhëniet e njeriut me mjedisin. | Situata e të nxënit: ➤ Si ka ndryshuar lagjja juaj ndër vite? | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton veprimin e njeriut në mjedis ➤ Evidenton ndryshimet që njeriu i ka sjellë mjedisit ➤ Analizon rëndësinë që ka mjedisi për njeriun | Fjalët kyçe: Mjedis, ndërhyrje, mbrojtje, ruajtje e mjedisit. | |
| Burimet: Teksti, interneti | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, qytetaria | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve**Struktura e mësimit**


| | | |
|----------|------------------------------|--------------------|
| E | Brainstorming | 5 min |
| R | Teknika e të pyeturit | 25 – 30 min |
| R | Ditari dypjesësh | 10 min |

Zhvillimi i mësimit**Evokimi (Brainstorming)**

Mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimit dhe u kërkon nxënësve të japin mendimet e tyre rreth temës. Mësuesi i shkruan ato në tabele sipas skemës.

Marrëdhëniet e njeriut me mjedisin


(Fjalët futen brenda rrethit)

**Realizimi i të kuptuarit (Teknika e të pyeturit)**

Mësuesi për disa minuta dhe duke pasur parasysh hartën e të pyeturit shpjegon thelbin e mësimit duke u ndalur sidomos në kuptimin e fjalëve kyç.

Ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep hartën e të pyeturit me temën “Marrëdhëniet e njeriut me mjedisin”.

Më pas i fton nxënësit të lexojnë materialin dhe të vizojnë ato çështje që do të ndihmojnë nxënësit për t’iu përgjigjur pyetjeve. Nxënësit e çdo grupi diskutojnë përgjigjet e mundshme të pyetjeve dhe i shënojnë ato në fletore duke ndjekur radhën e pyetjeve në hartën e të pyeturit.



Reflektimi (Ditari dy pjesësh)

Në këtë fazë dhe në këtë temë nxënësi punon në mënyrë të pavarur për rreth 10 min duke komentuar citatin e dhënë nga mësuesja.

| Citati | Komenti |
|--|---------|
| Ngjyrat janë buzëqeshja e natyrës <i>Leigh Hunt</i> | |

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Çfarë problemesh shqetësojnë komunitetin tuaj? Çfarë do t'i kërkonit Kryetarit të Bashkisë të bënte për t'i rregulluar?

Planifikimi i orës mësimore Nr. 4


| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi Lënda: Gjeografi | Shkalla: III Klasa: VI |
|---|---|
| Tema mësimore: ➤ Peizazhi natyror dhe njerëzor | Situata e të nxënit: ➤ Veprintari: Shohim mjedisin përreth. ➤ Çfarë vërejmë? |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton kuptimin e termit peizazh ➤ Evidenton dallimet ndërmjet peizazhit natyror dhe njerëzor ➤ Analizon rëndësinë e peizazhit për njeriun | Fjalët kyçe: Peizazh natyror, peizazh njerëzor |
| Burimet: Teksti, foto peizazhesh. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, artet. |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve
Struktura e mësimit

| | | |
|----------|-------------------------|--------------------|
| E | Brainstorming | 5 min |
| R | INSERT | 25 – 30 min |
| R | Diagrami i Venit | 10 min |

Zhvillimi i mësimit
Evokimi (Brainstorming)

Vendosim në tabelë dy foto të dy peizazheve, njëri natyror dhe tjetri njerëzor dhe i tregohet nxënësve se këtë orë do të studiojmë peizazhin natyror dhe njerëzor. Nxënësve iu kërkohet të shikojnë peizazhet e të tregojnë se çfarë shohin në to. Mendimet i shkruajmë në tabelë:

Shkruajmë brenda rrethit peizazhi natyror dhe njerëzor

Realizimi i të kuptuarit (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë temën e mësimit në tekst duke mbajtur shënime me anë të shenjave \surd , +, -, ? të tabelës INSERT duke nënvizuar materialin. Më pas pjesët e nënvizuara hidhen në tabelë sipas shenjave.


| “ \surd ” | “ + ” | “ - ” | “ ? ” |
|-------------|-------|-------|-------|
| | | | |

Reflektimi (Diagrami i Venit)

Krahaso:

Peizazhi natyror

Peizazhi njerëzor



Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Vizato ose përshkruaj peizazhin tënd ideal.

Planifikimi i orës mësimore Nr 5

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|--|--------------------------------|---|------------------|
| Tema mësimore: ➤ Orientimi në natyrë | | Situata e të nxënit: ➤ Përse përdoret Busulla? | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton se çdo të thotë të orientohesh ➤ Evidenton disa nga mënyrat e orientimit ➤ Analizon rëndësinë e orientimit në natyrë | | Fjalët kyçe: Orientim, horizont, vijë horizonti, busull, ylli polar, LINDJE, PERËNDIM, VERI, JUG. | |
| Burimet: Teksti, busull. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi. | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e mësimit | | | |
| E | Parashikimi me terma paraprakë | 5 min | |
| R | Teknika e të pyeturit | 25 – 30 min | |
| R | Shkrim i lirë | 10 min | |

Evokimi (Parashikimi me terma paraprakë)


Shënojmë në fillim disa terma paraprakë si:

- *Orientim *Anët e horizontit *Ylli polar *Busulla

- Mësuesi u kërkon nxënësve të formulojnë me shkrim nga një fjali për çdo term por që të kenë lidhje me njëra-tjetrën.
- Shkruhen në tabelë variantet më interesante të fjalive të krijuara nga nxënësit.

Realizimi i të kuptuarit (Teknika e të pyeturit)

- Mësuesi për disa minuta dhe duke pasur parasysh hartën e të pyeturit shpjegon thelbin e mësimit duke u ndalur sidomos në kuptimin e fjalëve kyç.
- Ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep hartën e të pyeturit me temën “Orientimi në natyrë”.
- Më pas i fton nxënësit të lexojnë materialin dhe të vizojnë ato çështje që do të ndihmojnë nxënësit për t’iu përgjigjur pyetjeve.
- Nxënësit e çdo grupi diskutojnë përgjigjet e mundshme të pyetjeve dhe i shënojnë ato në fletore duke ndjekur radhën e pyetjeve në hartën e të pyeturit.



Reflektimi (Shkrim i lirë)

Si do të orientohesh në një vend të panjohur?

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Merrni si pikë referimi shkollën tuaj dhe tregoni e shkruani të gjitha objektet e rëndësishme në të gjitha anët e horizontit të shkollës.

Planifikimi i orës mësimore Nr. 6

| | | | |
|--|--|--------------------|--------------|
| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi Lënda: Gjeografi | Shkalla: III Klasa: VI | | |
| Tema mësimore: ➤ Vendndodhja gjeografike | Situata e të nxënit: ➤ Ku ndodhet avioni i rrëzuar që ka nevojë të menjëhershme për tu ndihmuar? | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton se çdo të thotë të orientohesh ➤ Evidenton disa nga mënyrat e orientimit ➤ Analizon rëndësinë e orientimit në natyrë | Fjalët kyçe: Orientim, horizont, vijë horizonti, busull, ylli polar, LINDJE, PERËNDIM, VERI, JUG. | | |
| Burimet: Teksti, busull. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi. | | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përkufizon termin vendndodhje absolute, paralel, meridian, vendndodhje relative. ➤ Përcakton në hartë dhe glob paralelet, meridianët, rrethin polar verior, jugor dhe madhësitë e tyre. | Fjalët kyçe: Vendndodhje absolute, paralele, meridianë, ekuatori, meridiani Grinuiç, vendndodhje relative. | | |
| Burimet: teksti, harta. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, matematika. | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e orës mësimore | | | |
| E | Parashikimi me terma paraprakë | 5 min | |
| R | Metoda e kombinimit | 25 – 30 min | |
| R | Turi i galerisë | 10 min | |
| Evokimi (Parashikimi me terma paraprakë) | | | |
| Shënojmë në fillim disa terma paraprakë si: | | | |
| *Vendndodhje | * Polet | * Paralelet | * Meridianët |
| Mësuesi u kërkon nxënësve të formulojnë me shkrim nga një fjali për çdo term por që të kenë lidhje me njëra-tjetrën. | | | |
| Shkruhen në tabelë variantet më interesante të fjalive të krijuara nga nxënësit. | | | |

Realizimi i të kuptuarit (Metoda e kombinimit)

- Formohen grupet fillestare të bashkëpunimit dhe nxënësit pajisen me tekstin përmbledhës të temës dhe me fletët e ekspertit, sipas zgjedhjes.

- Më pas nxënësit rigrupohen sipas numrave përkatës dhe krijohen grupet e ekspertëve.

- Në fund kthehen nxënësit në grupet fillestare të bashkëpunimit, tashmë të përgatitur si ekspertë për t'ua shpjeguar të tjerëve.

Grupi i I – Vendndodhja absolute

Grupi i III – Meridianët

Grupi i II – Paralelet

Grupi i IV – Vendndodhja relative

(Mësuesi fotokopjon materialet përkatëse duke i quajtur fleta eksperti)

Të gjitha të dhënat bashkë me shembujt që grupet kanë sjellë përmbledhen dhe shënohen në letër flipçart duke u afishuar në një vend të dukshëm.

Reflektimi (Turi i galerisë)

Të gjithë nxënësit lexojnë materialet e afishuara dhe ata mund të diskutojnë apo shtojnë mendime të tjera në to.

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Duke parë hartën tregoni 3 qytete që ndodhen midis paraleleve 30° dhe 60° në hemisferën veriore, dhe 3 të tjerë midis meridianëve 20° dhe 100° në hemisferën lindore.

Planifikimi i orës mësimore Nr. 7

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|---|-------------------------|--|------------------|
| Tema mësimore: Koordinatat gjeografike | | Situata e të nxënit: Ku ndodhet avioni i rrëzuar që ka nevojë të menjëhershme për tu ndihmuar? | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: -Përcakton se ç'janë koordinatat gjeografike. -Përdor koordinatat gjeografike për të gjetur pozicionin gjeografik të vendeve të ndryshme në rruzullin tokësor. | | Fjalët kyçe: Koordinata gjeografike, pozicion gjeografik, gjatësi gjeografike, gjerësi gjeografike, rrjet i gradëve. | |
| Burimet: Teksti, harta, rrjet koordinativ i improvizuar. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, matematika, qytetaria. | |

Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Struktura e mësimit

| | | |
|----------|---------------------------------------|--------------------|
| E | Parashikimi me terma paraprakë | 5 min |
| R | Teknika e të pyeturit | 25 – 30 min |
| R | Mendo, puno në dyshe, shkëmbe | 10 min |

Evokimi (Parashikimi me terma paraprakë)


Shënojmë në fillim disa terma paraprakë si:

- | | |
|-------------------------|----------------------------------|
| *Koordinata gjeografike | * Rrjet koordinativ |
| *Pozicion gjeografik | *Gjatësi dhe gjerësi gjeografike |

Mësuesi u kërkon nxënësve të formulojnë me shkrim nga një fjali për çdo term por që të kenë lidhje me njëra-tjetrën. Shkruhen në tabelë variantet më interesante të fjalive të krijuara nga nxënësit.

Realizimi i të kuptuarit (Teknika e të pyeturit)

- Mësuesi për disa minuta dhe duke pasur parasysh hartën e të pyeturit shpjegon thelbin e mësimit duke u ndalur sidomos në kuptimin e fjalëve kyç.
- Ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep hartën e të pyeturit me temën “Koordinatat Gjeografike”.
- Më pas i fton nxënësit të lexojnë materialin dhe të vizojnë ato çështje që do të ndihmojnë nxënësit për t’iu përgjigjur pyetjeve.
- Nxënësit e çdo grupi diskutojnë përgjigjet e mundshme të pyetjeve dhe i shënojnë ato në fletore duke ndjekur radhën e pyetjeve në hartën e të pyeturit.



Reflektimi (Mendo, puno në dyshe, shkëmbe)

Mësuesi jep disa ushtrime dhe nxënësi punon në çift në harta dhe atlaset e tyre:

Ushtrimi 1: Gjej në hartë koordinatat gjeografike të kryeqyteteve si: Madrid, Paris, Brazilia, Pekin, Los Angelos (këto të konsiderohen si pika) dhe të shteteve si: Portugali, Itali, Japoni, Argjentinë, Britania e Madhe (këto konsiderohen si territore).

Ushtrimi 2: Jepen koordinata gjeografike dhe gjenden pika dhe territore të panjohura.


Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Gjeni koordinatat gjeografike të pesë shteteve që ju dëshironi dhe paraqitini ato para shokëve të klasës.

Planifikimi i orës mësimore Nr. 9

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|--|-------------------------|---|------------------|
| Tema mësimore: ➤ Globi dhe përdorimet e tij. | | Situata e të nxënit: ➤ Vihet për tu dëgjuar kënga “Dhuratë për ditëlindje” | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton se ç’është globi. ➤ Evidenton llojet e globeve që përdoren në shkollë. ➤ Analizon rëndësinë e përdorimit të globit | | Fjalët kyçe: Glob, glob fizik, glob politik, glob induksioni. | |
| Burimet: Teksti, globi, harta. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Muzika | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve Struktura e mësimi | | | |
| E | Brainstorming | 5 min | |
| R | INSERT | 25 – 30 min | |
| R | Diagrami i Venit | 10 min | |
| Zhvillimi i mësimi | | | |
| Evokimi (Brainstorming) | | | |
| Vendosim në tavolinë globin dhe i tregohet nxënësve se këtë orë do të studiojmë globin dhe përdorimet e tij. Nxënësve iu kërkohet të tregojnë se çfarë dinë për globin. Mendimet i shkruajmë në tabelë: | | | |
| Shkruajmë brenda rrethit fjalën GLOBI | | | |
|  | | | |


Realizimi i të kuptuarit (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë temën e mësimit në tekst duke mbajtur shënime me anë të shenjave $\sqrt{\quad}$, +, -, ? të tabelës INSERT duke nënvizuar materialin. Më pas pjesët e nënvizuara hidhen në tabelë sipas shenjave.

| “ $\sqrt{\quad}$ ” | “ + ” | “ - ” | “ ? ” |
|--------------------|-------|-------|-------|
| | | | |

Reflektimi (Diagrami i Venit)

Krahaso:



Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruani një ese me temën “ Udhëtim imagjinar nëpër glob ”

Planifikimi i orës mësimore Nr. 8

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|--|------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: Hartat, klasifikimi dhe llojet e tyre. | | Situata e të nxënit: Harta e Botës dhe e Shqipërisë. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: -Përkufizon kuptimin mbi termin hartë -klasifikon hartat sipas përmbajtjes së tyre -Evidenton llojet e hartave -Analizon përmbajtjen e hartave mësimore | | Fjalët kyçe: Hartë e përgjithshme, hartë tematike, klasifikim i hartave, shkallë e hartës, hartë fizike, hartë politike, hartë ekonomike. | |

| | |
|--|--|
| Burimet: Teksti, harta. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, |
| Vlerësimi | |
| Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit. | |
| Detyrat dhe puna e pavarur: | |
| Me ndihmën e mësuesit apo të prindërve plotësoni hartën politike të Ballkanit. | |


Planifikimi i orës mësimore Nr. 10

| | | | |
|--|-------------------------|--|------------------|
| Fusha: Shoqëria dhe Mjedis | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
| Tema mësimore: ➤ Përbërja e trevave shqiptare | | Situata e të nxënit: ➤ Pyetja: Pse themi shqiptarët e Strugës, Ohrit, Preshevës, Ulqinit, Janinës. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton në hartë trevat shqiptare ➤ Evidenton pozicionin gjeografik të trevave shqiptare dhe rëndësinë që ka ajo ➤ Analizon rëndësinë e pozitës gjeografike të trevave shqiptare | | Fjalët kyçe: Trevë shqiptare, pozita gjeografike, qytete antike, rrugë ndërkombëtare, | |
| Burimet: Teksti | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, Histori. | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e mësimit | | | |
| E | Brainstorming | 5 min | |
| R | INSERT | 25 – 30 min | |
| R | Kllaster | 10 min | |

Zhvillimi i mësimi
Evokimi (Brainstorming)

Vendosim në tabelë hartën e trevave shqiptare dhe i tregohet nxënësve se këtë orë do të studiojmë përbërjen dhe shtrirjen e trevave shqiptare. Nxënësve iu kërkohet të tregojnë se çfarë dinë për trevat shqiptare. Mendimet i shkruajmë në tabelë:

Trevat shqiptare
(Shkruajmë brenda rrethit togfjalëshin)




Realizimi i të kuptuarit (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë temën e mësimi në tekst duke mbajtur shënime me anë të shenjave √, +, -, ? të tabelës INSERT duke nënvizuar materialin. Më pas pjesët e nënvizuara hidhen në tabelë sipas shenjave.

| “ √ ” | “ + ” | “ - ” | “ ? ” |
|-------|-------|-------|-------|
| | | | |

Reflektimi (Kllaster)

Brenda rrethit të madh shënojmë **përbërja e trevave shqiptare**
Rrethi i majte cilat janë rrethi djathte ç’rëndësi ka pozita gjeografike e tyre




Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:


Cilin nga qytetet e trevave shqiptare ke vizituar? Ç’ dini për të?

Planifikimi i orës mësimore Nr. 11

| | | | |
|--|---------------------------|--|------------------|
| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
| Tema mësimore: ➤ Lëvizjet e popullsisë | | Situata e të nxënit: ➤ Largimi i disa nxënësve në Gjermani. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakto kuptimin e termit emigrim dhe shkaqet e tij. ➤ Evidento ndryshimin ndërmjet emigrimit të jashtëm dhe të brendshëm të popullsisë. ➤ Argumento ku qëndron problematika e lëvizjes së popullsisë | | Fjalët kyçe: Emigrim, emigrim i jashtëm, emigrim i brendshëm, pasoja pozitive, pasoja negative | |
| Burimet: Teksti, media. | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, qytetari | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e mësimit | | | |
| E | Brainstorming | 5 min | |
| R | Teknika e pyetjeve | 25 – 30 min | |
| R | Shkrim i lirë | 10 min | |
| Zhvillimi i mësimit Evokimi (Brainstorming) | | | |
| Shkruajmë në tabelë temën e mësimit dhe i tregohet nxënësve se këtë orë do të studiojmë lëvizjet e popullsisë pra migrimet. Nxënësve iu kërkohet të tregojnë se çfarë dinë rreth këtij fenomeni. Mendimet i shkruajmë në tabelë: | | | |
| Lëvizjet e popullsisë (Shkruajmë brenda rrethit togfjalëshin) | | | |
|  | | | |

Realizimi i të kuptuarit (Teknika e të pyeturit)

- Mësuesi për disa minuta dhe duke pasur parasysh hartën e të pyeturit shpjegon thelbin e mësimit duke u ndalur sidomos në kuptimin e fjalëve kyç.
- Ndan klasën në grupe dhe secilit grup i jep hartën e të pyeturit me temën “Lëvizjet e popullsisë”.
- Më pas i fton nxënësit të lexojnë materialin dhe të vizojnë ato çështje që do të ndihmojnë nxënësit për t’iu përgjigjur pyetjeve. Nxënësit e çdo grupi diskutojnë përgjigjet e mundshme të pyetjeve dhe i shënojnë ato në fletore duke ndjekur radhën e pyetjeve në hartën e të pyeturit.



Reflektimi (Shkrim i lirë)

Migrimi.

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shkruaj një ese me temë “Sa më mungon shoku apo kushëri!”

Planifikimi i orës mësimore Nr. 12

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedisi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|---|------------------|---|-----------|
| Tema mësimore: ➤ Trashëgimia natyrore dhe kulturore Botërore dhe Kombëtare | | Situata e të nxënit: ➤ UNESCO dhe trevat shqiptare. | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton disa site të Trashëgimisë Botërore nga Hapësira Shqiptare. ➤ Analizon vlerat e Siteve të Trashëgimisë Botërore nga hapësira shqiptare. ➤ Analizon problemet e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore të trevave shqiptare. | | Fjalët kyçe: Trashëgimi kulturore, trashëgimi natyrore, sit, Trashëgimi Botërore. | |

| | | | | | | |
|--|--|----------------------------|-------------------------------------|-------------|------------------------|---------------------|
| Burimet: Teksti | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, historia, qytetaria | | | | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | | | | |
| Struktura e mësimi | | | | | | |
| E | Brainstorming | | | | | 5 min |
| R | Metoda e kombinimit | | | | | 25 – 30 min |
| R | Tabela përmbledhëse e koncepteve | | | | | 10 min |
| Realizimi i të kuptuarit (Metoda e kombinimit) | | | | | | |
| - Formohen grupet fillestare të bashkëpunimit dhe nxënësit pajisen me tekstin përmbledhës të temës dhe me fletët e ekspertit, sipas zgjedhjes. | | | | | | |
| - Më pas nxënësit rigrupohen sipas numrave përkatës dhe krijohen grupet e ekspertëve. | | | | | | |
| - Në fund kthehen nxënësit në grupet fillestare të bashkëpunimit, tashmë të përgatitur si ekspertë për t ua shpjeguar të tjerëve. | | | | | | |
| Grupi i I – Liqeni i Ohrit | | | Grupi i IV – Gjirokastra | | | |
| Grupi i II – Parku Kombëtar i Butrintit | | | Grupi i V – Qyteti i Ohrit | | | |
| Grupi i III – Berati | | | Grupi i VI – Manastiri i Deçanit | | | |
| (Mësuesi fotokopjon materialet përkatëse duke i quajtur fleta ekspertit) | | | | | | |
| Secili grup plotëson tabelën | | | | | | |
| Emërtimi | Ku ndodhet | | Kur u shpall Trashëgimi Botërore | | Përse u shpall i tillë | |
| Liqeni i Ohrit | | | | | | |
| Kështu vepronjë të gjitha grupet për detyrat e tyre. | | | | | | |
| Reflektimi (Tabela përmbledhëse e koncepteve) | | | | | | |
| Sitet | Liqeni i Ohrit | Parku Kombëtar i Butrintit | Berati | Gjirokastra | Qyteti i Ohrit | Manastiri i Deçanit |
| Ku ndodhen këto site? | | | | | | |
| Kur u shpallën TB? | | | | | | |
| Përse u shpallën? | | | | | | |

| |
|---|
| Vlerësimi |
| Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit |
| Detyrat dhe puna e pavarur: |
| Çfarë sitiesh të TB nga natyra apo kultura shqiptare keni afër mjedisit ku ju jetoni? Studiojeni edhe më shumë atë. |

Planifikimi i orës mësimore Nr. 13

| | | | |
|---|---------------------------------------|--|------------------|
| Fusha: Shoqëria dhe Mjedi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
| Tema mësimore: ➤ Aktiviteti prodhues | | Situata e të nxënit: Pyetja: çfarë keni konsumuar sot për mëngjes? Ku janë prodhuar? | |
| Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: ➤ Përcakton degët e ekonomisë në trevat shqiptare. ➤ Analizon degët e ekonomisë sipas rëndësisë që ato kanë. | | Fjalët kyçe: Sektorët e ekonomisë, industri, bujqësi, blegtori, tregti, transport, turizëm, artizanat. | |
| Burimet: Teksti | | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e mëimit | | | |
| E | Parashikimi me terma paraprakë | 5 min | |
| R | INSERT | 25 – 30 min | |
| R | Kllaster | 10 min | |

Evokimi (Parashikimi me terma paraprakë)

Shënojmë në fillim disa terma paraprakë si:

*Bujqësi

*Industri

* Transport

* Turizëm


Mësuesi u kërkon nxënësve të formulojnë me shkrim nga një fjali për çdo term por që të kenë lidhje me njëra-tjetrën. Shkruhen në tabelë variantet më interesante të fjalive të krijuara nga nxënësit.

Realizimi i të kuptuarit (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë temën e mësimit në tekst duke mbajtur shënime me anë të shenjave √, +, -, ? të tabelës INSERT duke nënvizuar materialin. Më pas pjesët e nënvizuara hidhen në tabelë sipas shenjave.

| “ √ ” | “ + ” | “ - ” | “ ? ” |
|-------|-------|-------|-------|
| | | | |

Reflektimi (Kllaster)



Brenda rrethit te madh shënojmë **aktiviteti prodhues**

Rrethi i majte shënojmë Bujqësia, rrethi djathte industria dhe shtojmë një rreth poshtë ku shënojmë transporti tregtia turizmi shërbimet dhe artizanati.

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Çfarë aktiviteti prodhues ka në mjedisin ku ti jeton? Nëse ka ndonjë fabrikë interesohu dhe merr të dhëna për të (sa e madhe është, sa punëtorë ka, çfarë prodhon, a eksporton, cilët janë investuesit etj?).

Planifikimi i orës mësimore Nr 14

| Fusha: Shoqëria dhe Mjedi | Lënda: Gjeografi | Shkalla: III | Klasa: VI |
|--|---|---------------------|------------------|
| Tema mësimore: Mjedi dhe njeriu | Situata e të nxënësit: Kronika në TV për ndërtimin e landfillit të plehrave në një ndër qytetet më të ndotura në Shqipëri në Elbasan. | | |
| Rezultatet e të nxënësit të kompetencave të fushës/lëndës sipas temës mësimore: -Evidenton problemet e mjedisit në trevat shqiptare -Shpjegon masat që duhet të merren për mbrojtjen e mjedisit -Analizon gjendjen e sotme të mjedisit | Fjalët kyçe: mjedi, edukim ekologjik, ndotje, biodiversitet, probleme mjedisore. | | |
| Burimet: Teksti, media. | Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Gjuha dhe komunikimi, biologji, qytetari. | | |
| Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve | | | |
| Struktura e mësimit | | | |
| E | Brainstorming | 5 min | |
| R | INSERT | 25 – 30 min | |
| R | Shkrim i lirë | 10 min | |


Zhvillimi i mësimit

Evokimi (Brainstorming)

Shkruajmë në tabelë temën e mësimit dhe i tregohet nxënësve se këtë orë do të studiojmë rreth temës Mjedisi dhe njeriu.. Nxënësve iu kërkohet të tregojnë se çfarë dinë rreth këtij fenomeni. Mendimet i shkruajmë në tabelë

Mjedisi dhe njeriu

(Shkruajmë brenda rrethit togfjalëshin)



Realizimi i të kuptuarit (INSERT)

Udhëzohen nxënësit të lexojnë temën e mësimit në tekst duke mbajtur shënime me anë të shenjave √, +, -, ? të tabelës INSERT duke nënvizuar materialin. Më pas pjesët e nënvizuara hidhen në tabelë sipas shenjave.

| “ √ ” | “ + ” | “ - ” | “ ? ” |
|-------|-------|-------|-------|
| | | | |

Reflektimi (Shkrim i lirë)

Gjendja e mjedisit në të cilin ti jeton.

Vlerësimi

Nxënësi vlerësohet për pjesëmarrjen, aktivizimin dhe saktësinë e mendimeve të tij. Vlerësimi i tij bëhet sipas niveleve të vlerësimit.


Detyrat dhe puna e pavarur:

Evidento një problem në mjedisin ku ti jeton, ngri zërin për këtë problem duke propozuar edhe zgjidhje nëse mundesh.


PËRSËRITJE: GJEOGRAFIA DHE KËRKIMI GJEOGRAFIK

Shpjego fjalët: gjeografi, rajon, vend, lëvizje, lidhje e njeriut me mjedisin, peizazh, peizazh natyror, peizazh njerëzor, orientim.


Ndërto hartën e mendjes.



Krahaso objektin e studimit të Gjeografisë Fizike me objektin e studimit të Gjeografisë Humane.



Krahaso peizazhin natyror me atë njerëzor.



Provo nëse e di

- Si ndikojnë në mjedis tek njëri-tjetri dy elementë natyror?
- Si ndikojnë në mjedis një element natyror dhe një grup njerëzor?
- Si ka vepruar njeriu në mjedis?
- Cilat janë pasojat e veprimit të tij?
- Çdo të thotë të orientohesh?
- Si mund të orientohemi në mjedis?

Shpjego lidhjen shkak – pasojë duke shfrytëzuar fotot e mëposhtme.

Pyll i prerë



Ajër i ndotur



Marrja e inerteve tek lumenjtë



Përmbytje




10. PËRSËRITJE HARTAT GJEOGRAFIKE


Shpjego fjalët: vendndodhje absolute, vendndodhje relative, paralel, ekuator, meridian, gjatësi gjeografike, gjerësi gjeografike, koordinata gjeografike, hartë, glob, plan.

Provo nëse e di


1. Ç'është vendndodhja absolute dhe relative?
2. Ç'janë paralelet?
3. Ç'janë meridianët?
4. Ç'është gjerësia gjeografike?
5. Ç'është gjatësia gjeografike?
6. Përcakto në glob ose në hartë vende të ndryshme me gjatësi dhe gjerësi gjeografike të ndryshme.
7. Ç'janë koordinatat gjeografike?
8. Puno në rrjetin koordinativ duke gjetur koordinatat e pikave 1, 2, 3 dhe territoreve A, B, C.




9. Krahaso planin me fotografinë.



10. Puno me hartën e të pyeturit.



11. Ku ndryshon harta nga globi?



PËRSËRITJE

MJEDISI YNË

Shpjego fjalët: pozita gjeografike, natyra e trevave, reliev i ulët, reliev i mesëm, reliev i lartë, emigrim, shtim natyror, trashëgimi kulturore, trashëgimi natyrore, polifoni, qark, bashki, komunë, mjedis, edukim ekologjik.

| Hapësira shqiptare | Mjedisi ku ti jeton |
|--|---|
| Cila është pozita gjeografike e hapësirës shqiptare? | Po mjedisi ku ti jeton, ç'pozitë gjeografike ka? |
| Çfarë formash relievi mbizotërojnë në hapësirën shqiptare? | Po në mjedisin ku ti jeton? A mund të tregoni konkretisht disa male, fusha të këtij mjedisi? |
| Cilat janë llojet e klimave që takojmë në hapësirën shqiptare? | Po në mjedisin tënd? |
| Përcakto në hartë disa nga lumenjtë e hapësirës shqiptare. | Përcakto në hartë se cili nga këta lumenj kalon në territorin e mjedisit tënd. |
| Cilat janë bimët dhe kafshët e hapësirës shqiptare? | A njeh ti bimë e kafshë nga mjedisi yt? Cilat janë ato? |
| Cilat janë tiparet e popullsisë së hapësirës shqiptare? | Çfarë tiparësh ka popullsia e mjedisit ku ti jeton? |
| Ç'është emigrimi e sa llojesh e kemi atë dhe ç'pasoja ka kjo dukuri? | Ç'lloj emigrimi e ka prekur popullsinë e mjedisit ku ti jeton? Cilat janë drejtimet e këtij emigrimi? A ka sjellë probleme kjo dukuri e pse? |
| Ç'kupton me trashëgimi natyrore dhe kulturore? Si mund të regjistrohet një sit në listën e trashëgimisë botërore? Përcaktoni disa site të trashëgimisë natyrore dhe kulturore botërore nga hapësira shqiptare. | Po në mjedisin tuaj, cilat janë disa nga sitet e TK-së dhe TN-së? |
| Cilët janë sektorët e ekonomisë së hapësirës shqiptare? | Po në mjedisin ku ti jeton, çfarë aktiviteti prodhues ka? |
| Çfarë problemesh mjedisore evidentohen sot në hapësirën shqiptare? Ç'duhet bërë për t'i zgjidhur ato? | Çfarë problemesh mjedisore hasen në mjedisin ku ti jeton? Çfarë është bërë për përmirësimin e situatës? Çfarë prisni në të ardhmen për një mjedis edhe më të shëndetshëm? |

TESTIM

1. A janë të vërteta pohimet? Vendos Po ose Jo. (5 pikë)

- Fjala gjeografi u përdor për herë të parë nga dijetari grek Erastoteni _____.
- Karakteristikat kulturore të një vendi kanë të bëjnë me malet, fushat dhe bukuritë e tyre _____.
- Gjeografia humane studion edhe vendbanimet _____.
- Në mjedis janë bërë ndryshime të mëdha të cilat shpeshherë kanë qenë të paplanifikuara e që kanë pasur pasoja negative _____.
- Sateliti mund të bëjë dhe skanimin e kores së tokës për të dhënë njohuritë ndryshme për mineralet që gjenden në të _____.

2. Evidento objektin e studimit të gjeografisë fizike (4 pikë)

.....

.....

.....

.....

.....

3. Plotëso fjalitë (3 pikë)

- Pasi gjeografët mbledhin dhe përpunojnë të dhënat e ndryshme rreth një problemi të caktuar e paraqesin atë me anë të
- Një përfytyrim më të qartë rreth dukurive fizike dhe humane që ndodhin në rruzullin tokësor është metoda e
- Me rajon do të kuptojmë

4. Listo tre peizazhe natyrore, tre peizazhe njerëzore dhe përshkruaj atë që të pëlqen më shumë. (4 pikë)

.....

.....

.....

5. Analizo disa nga masat që duhet të marrim për mbrojtjen e mjedisit. (6 pikë)

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

.....

6. Qarko alternativën e saktë (3 pikë)

Gjeografia fizike studion:

- Popullsinë
- Organizimin e shtetit
- Klimën
- Ekonominë

Një përfytyrim më të qartë rreth dukurive fizike dhe humane që ndodhin në rruzullin tokësor na e jep

- Metoda eksperimentale
- Metoda e vrojtimit
- Metoda e krahasimit
- Metoda statistikore

Një nga pesë temat e gjeografisë që studion karakteristikat fizike dhe kulturore të një territori është

- Vendi
- Lidhja e njeriut me mjedisin
- Lëvizja
- Rajoni

7. Argumento rëndësinë e studimit të gjeografisë duke dhënë sa më shumë shembuj (7 pikë)

| | | | | | | | |
|-------|-------|--------|---------|---------|---------|---------|---------|
| Nota | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| Pikët | 0 - 7 | 8 - 12 | 13 - 17 | 18 - 21 | 22 - 25 | 26 - 29 | 30 - 32 |

TESTIM

1. A janë të vërteta pohimet? Vendos po ose jo. (5 pikë)

- Gjatë shekujve të kaluar hartat kanë qenë të sakta _____.
- Në lëndën e gjeografisë do të mësojmë edhe si të orientohemi _____.
- Koordinatat gjeografike përcaktohen nga dy madhësi, gjerësia dhe gjatësia gjeografike _____.
- Shigjeta e busullës tregon gjithnjë jugun _____.
- Fusha e futbollit në shkollën tonë gjendet në anën jugore _____.

2. Plotëso fjalinë: (4 pikë)

- Vija të panumërta imagjinare që rrethojnë globin quhen
- Ngjyra kafe në një hartë tregon
- Dielli fshihet gjithmonë në të njëjtin vend dhe ky është
- Hartat gjeografike përmbajnë element të shumtë të cilat ndahen në elementë dhe

3. Çfarë është horizonti? Jep shembull të një horizonti të mbyllur. (3pikë)

.....
.....
.....

4. Ç'është plani? (3 pikë)

.....
.....
.....

5. Ç'është gjerësia gjeografike? (4 pikë)

.....
.....
.....

6. Ç'është vendndodhja relative? Trego vendndodhjen relative të mjedisit ku ti jeton. (3 pikë)

.....
.....
.....

7. Ç'farë tregon harta politike? (3pikë)

.....

.....

.....

.....

8. Ku ndryshon plani nga harta? (5pikë)


.....

.....

.....

.....

9. Gjej vendodhjen absolute të pikave A e B, dhe territoreve C e D (7pikë).



| | | | | | | | |
|-------|--------|---------|---------|---------|---------|---------|---------|
| Nota | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| Pikët | 0 - 10 | 11 - 15 | 16 - 20 | 21 - 24 | 25 - 29 | 30 - 33 | 34 - 37 |

Lenda: Gjeografi

Klasa: VI

Plani i projektit mësimor

TEMA: NDOTJA E MJEDISIT NË MJEDISIN KU JU JETONI DHE ROLI I SHOQËRISË NË TË

(Në përfundim të realizimit të këtij projekti, nxënësi:)

- Përcakton llojet e ndotjeve që janë prezente në mjedisin shqiptar dhe në zonën ku banon në veçanti. (*niveli i ulët*)
- Analizon llojet e ndotjeve në mjedis dhe ndikimin e shoqërisë shqiptare në të (*niveli mesatar*)
- Jep gjykimin e tij mbi shkallën e lidhjes mjedis-shoqëri dhe aftësohet për të qenë individ aktiv në mbrojtje dhe përmirësim të mjedisit që e rrethon (*niveli i lartë*)

MJETET QË DO TË PËRDOREN: Harta fizike e Shqipërisë, materiale të sjella nga nxënësit (fakte, argumente, statistika, modele, fotografi, albume, ese); lap-top.

PUNA PËRGATITORE:

Nxënësit diskutojnë që më parë për tematikën. Pasi ndahen në grupe, secili grup merr orientimet në lidhje me punën që do të bëjnë për grumbullimin e materialit që do të shfrytëzohet dhe do të ekspozohet në klasë.

FAZA E PARË:

Nxënësit ekspozojnë pamje dhe fotografi që paraqesin mjedise që kanë pësuar ndryshime nga ndërhyrja e shoqërisë njerëzore në periudha të ndryshme kohore. Në rastet kur shkolla apo niveli i klasës ofron mundësinë e përdorimit të kompjuterit, materiali mund të paraqitet me ndihmën e programit Power Point.

Gjatë kësaj faze, nxënësit arrijnë të dallojnë:

- Forma të ndryshme të ndotjes së mjedisit,
- Prezencën e faktorit njeri në këtë mjedis.

FAZA E DYTË:

Faza e dytë fillon në trajtën e një brainstorming-u dhe në tabelë krijohet një “hartë mendore” që përmbledh llojet e ndotjeve. Më pas, nxënësit kalojnë në analizën e:

- Secilës prej llojeve të ndotjeve, duke mbajtur edhe shënime në fletore,
- Shkallës së ndikimit të shoqërisë njerëzore në këto ndryshime që vihen re në mjediset e paraqitura.

FAZA E TRETË:

Gjatë kësaj faze (e fundit), nxënësit kalojnë në gjykimet e tyre dhe mbajnë qëndrim:

- Mbi shkallën e ndryshimit të mjedisit nga dora njerëzore.
- Përcaktojnë pasojat që do të rrjedhin n.q.s do të vazhdohet me këto ritme.
- Nxjerrin në pah edhe ndikimin pozitiv të shoqërisë njerëzore mbi mjedis.
- Pozicionojnë qëndrimin e tyre (si do të ishin ata aktivë në ndihmë të mjedisit dhe në uljen e nivelit të ndotjes në të). Gjatë trajtimit të kësaj tematike, disa nxënës mund të prezantojnë edhe esse, vizatime, makete, albume etj.

Lënda:Gjeografi

Klasa: VI

TEMA: TRASHËGIMIA NATYRORE DHE KULTURORE E MJEDISIT KU UNË JETOJ

Në përfundim të realizimit të këtij moduli, nxënësi:

- Identifikon objekte, mjedise apo elemente të trashëgimisë natyrore dhe kulturore të mjedisit ku banon. *(niveli i ulët)*
- Analizon rëndësinë dhe gjendjen aktuale të kësaj trashëgimie. *(niveli mesatar)*
- Jep gjykimin e tij mbi shkallën e ndërhyrjes të komunitetit në këtë trashëgimi dhe rëndësinë e kësaj trashëgimie në ndihmë të zhvillimit social-ekonomik dhe kulturor të mjedisit ku ai banon. *(niveli i lartë)*

KOHA NË DISPOZICION:

MJETET QË DO TË PËRDOREN: Teksti, materiale të sjella nga nxënësit: albume, fotografi ku paraqiten objekte apo mjedise të trashëgimisë natyrore, vargje këngësh, gjëgjëza, fjalë të urta, modele veshjeje popullore, objekte dhe elemente të ndryshme të traditës etj.

PUNA PËRGATITORE: Nxënësit njihen që më parë me tematikën. Pasi ndahen në grupe, secili grup merr orientimet në lidhje me punën që do të bëjnë për grumbullimin e materialit që do të shfrytëzohet dhe do të ekspozohet në klasë.

FAZA E PARË:

Ekspozohen në klasë nga grupet e nxënësve materialet e grumbulluara.

Gjatë kësaj faze, nxënësit arrijnë të identifikojnë:

- Trashëgiminë natyrore të mjedisit të tij.
- Trashëgiminë kulturore të mjedisit të tij.
- Vendi që zë kjo trashëgimi në shkallë vendi.

FAZA E DYTË:

Nxënësit kalojnë në:


- Prezantimin e vlerave që ka kjo trashëgimi.
- Prezantimin e gjendjes aktuale të kësaj trashëgimie.
- Analizën e rolit dhe ndikimit që ka luajtur kjo trashëgimi deri tashmë në zhvillim.

FAZA E TRETË:

Gjatë kësaj faze (e fundit), nxënësit japin gjykimet e tyre dhe mbajnë qëndrim:

- Mbi shkallën dhe mundësinë e ndërhyrjes së komunitetit në këtë trashëgimi.
- Mbi shkallën dhe mundësinë e mbrojtjes dhe pasurimit të kësaj trashëgimie nga komuniteti.
- Rëndësinë e kësaj trashëgimie në ndihmë të zhvillimit social-ekonomik dhe kulturor të mjedisit ku ai banon si edhe në shkallë vendi.

Në përfundim, me fotot e grumbulluara mund të formohet një album apo stendë në shkollë, me vargjet, gjeagjëzat apo fjalët e urta mund të krijojnë një fond të rëndësishëm për zhvillimin e tyre letrar, mund të jepet në televizionin lokal një kronikë e nxënësve ku të sensibilizojnë opinionin publik për gjendjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore etj. Me materialet e tjera të siguruar mund të krijohet një kënd ku paraqitet trashëgimia kulturore e zonës, krahinës apo qarkut në formën e një panairi.



Çmimi 500 lekë